

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 06.06.2023, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSI : z. Asllan Troksi, i lindur më 20.02.1958, në Surrel, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr 038756441 dhe nr personal F80225116V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar *(në cilësinë e Shitësit)*,

Dhe

BLERËS: shoqëria SUPERIOR GROUP shpk, person juridik i se drejtes shqiptare, me NUIS K91712015L, me seli në adresën: Autostrada Tirane- Durrës , nr i pasurise 168/52, Zk. 3266, Tirane, përfaqësuar nga administrator z.Altion Memushi, i lindur më 29.03.1973, në Frakull, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr 033575826 dhe nr personal H30329070G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar *(në cilësinë e Blerësit)*.

OBJEKTI

Shitja e 29.656 aksioneve të “BANKA CREDINS” sha., që zotërohen nga aksionari z. Asllan Troksi dhe blerja e tyre nga shoqëria SUPERIOR GROUP shpk.

PERMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria “BANKA CREDINS” Sha, është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr 28969 datë 31.01.2002, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K31608801O si dhe me Licencën Nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakort që 29.656 aksione të shiten me cmimin 50.000 Euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.



MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

- **Shitësi** është plotësisht dakort dhe i shet me vullnetin e tij të lirë e të plotë **Blerësit** 29.656 aksione të Shoqërisë “BANKA CREDINS” SHA, pjesë e paketës së aksioneve të tij, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.
- Nga ana e tij, **Blerësi, shoqëria SUPERIOR GROUP shpk** është plotësisht dakort të blejë 29.656 aksione të shoqërisë “BANKA CREDINS” SHA, të zotëruara nga shitësi në kapitalin aksionar të Bankës.
- Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 50.000 Euro nga ana e **Blerësit shoqëria SUPERIOR GROUP shpk**, në llogarinë e **Shitësit z. Asllan Troksi**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen te Blerësi sëbashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë cdo lloj dividenti, rritje kapitali, e drejta e votës dhe në përgjithësi cdo lloj e drejthe tjetër e papërmendur, por që njihet nga statute dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet sëbashku me transferimin e pronësisë mbi aksonet nga Shitësi te Blerësi me pagesën e cmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakort që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke pasur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËS

z. Asllan TROKSI

Asllan Troksi

BLERËS

SUPERIOR GROUP shpk

Administrator

Altion MEMUSHI

Altion Memushi

